

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

P. nr 118/11

Data: 2 dhjetor 2011

Trupi Kolegji prej tre gjyqtarëve i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit i përbërë prej gjykatëses së EULEX-it Mariola Pasnik si kryetare e trupit gjykues, gjykatësit të EULEX-it Dariusz Sielicki dhe gjyqtarit vendor Rasim Rasimit si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga procesmbajtësi Stephen Parkinson në lëndën penale kundër:

Shefqet Musliut, i lindur me 12.02.1963 në Konçul, Bujanovc, Serbi, shqiptar, banor i Gjilanit, Brigada e UÇK-së, kati i katërt, emri i babait Esat, emri i nënës Xhemile, profesioni mekanik, i martuar, ka fëmijë, ka mbaruar shkollimin fillor, ish komandant i shtabit të përgjithshëm të UÇPMB-së,

Besim Tahiri, (i njohur si Çeçen), i lindur me 18.08.1980, shqiptar, emri babait Nijazi, emri i nënës Emine, i pamartuar, ka përfunduar shkollimin e mesëm, bujk, gjendjen e rëndë ekonomike, momentalisht duke jetuar në fshatin Dobërçan, Kosovë,

të dy të akuzuar për veprën penale të rrëmbimit të dëshmitarit FY sipas nenit 64, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Penal të Serbisë në lidhje me nenin 22 të Ligjit penal të RSFJ-së (pika C e aktakuzës së përmirësuar),

Pas mbajtjes së séancës kryesore publike me 2 dhe 7 shtator, 25 tetor dhe 2 dhjetor 2011,

Në prani të dy të pandehurve, së bashku me Prokurorin Publik Fahri Nuhiun nga Gjilani PPQ dhe Prokurori i EULEX-it Elisa Moretti dhe avokatëve mbrojtës Masar Morina dhe Nike Shala,

Pas Njoftimit nga Kryeprokurori i EULEX-it, i paraqitur në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit me 4 tetor 2010, e cila ka qenë e rikonfirmuar verbalisht nga Prokurori Publik Fahri Nuhiu nga Gjilani, ZPPQ me 25 tetor 2011 dhe 2 dhjetor 2011, për tërheqje nga ndjekja kundër të pandehurve Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit për veprën penale të përmendur më lart,

Pas udhëzimeve nga Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin AP 351/2010, të datës 25 maj 2011 në lidhje me dënimin unik të të dy të pandehurve për veprat penale të rrëmbimit të dëshmitarit 3, dëshmitarit 4, dëshmitarit AK dhe për veprën penale të detyrimit të dëshmitarit 1 (të gjitha të konfirmuara me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP 470/2004 të datës 27 mars 2007)

Lëshon të mëposhtmin:

AKTGJYKIM

I.

Duke vepruar në pajtim me nenin 349, paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Penale (LPP), Gazeta Zyrtare 26/1986,

REFUZOHET akuza penale kundër të pandehurve SHEFQET MUSLIUT dhe BESIM TAHIRIT për veprën penale të rrëmbimit të dëshmitarit FY (pika C e aktakuzës së përmirësuar)

Për shkak se,

Me 17 gusht 2001, të pandehurit SHEFQET MUSLIU dhe BESIM TAHIRI, ia drejtuan dëshmitarit FY armën dhe e dërguan atë në një vend në pyll afër liqenit artificial ku e rrahën dhe e maltretuan. Më vonë atë e dërguan në një vend në Gjilan ku i ishte nënshtruar elektrohoku-ut dhe si rezultat i kësaj ai e humbi vetëdijen. Qëllimi i rrëmbimit ishte që të detyrojë FY-në të jep informata rreth një pamflete dhe ta shtyjnë atë të nënshkruaj një letër e cila do të mund të përdorej kundër tij.

Me të cilën ata kishin për të kryer veprën penale të kidnapimit në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 64, par. 1 dhe 2 i LPS në lidhje me nenin 22 të LPRFJ (pika C e aktakuzës së përmirësuar).

II.

Në pajtim me nenin 2, nënpar. 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe nenit 390 dhe nenit 357, paragrafi 5 i LPK

1. I pandehuri SHEFQET MUSLIU (me shënimet personale si më lart) ka qenë i shpallur fajtor më parë dhe i dënuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit në lëndën P.nr. 199/2003 të datës 25 qershor 2004 dhe i konfirmuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP 470/2004 të datës 27 mars 2007, me tetë (8) vite për secilën vepër penale të rrëmbimit të dëshmitarit 3 dhe dëshmitarit 4,

dhe

2. BESIM TAHIRI (me shënimet personale si më lart) ka qenë shpallur fajtor më parë dhe i dënuar me parë dhe i dënuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit në lëndën P.nr. 199/2003 të datës 25 qershor 2004 dhe i konfirmuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP 470/2004 të datës 27 mars 2007, me pesë (5) vite për secilën vepër penale të rrëmbimit të dëshmitarit 3 dhe dëshmitarit 4

Për shkak se,

Në një datë të panjohur të muajit shtator të vitit 2000, Besim Tahiri mori dy persona të cilët janë të referuar si dëshmitari numër 3 dhe dëshmitari numër 4 në procesverval nga vendi në fshatin Doberçan tek një ndërtesë në fshatin Dobrosin, shtabi i Shefqet Musliut, me lajthim në lidhje me dhënien e kontributit për UÇPMB-në dhe ti detyrojë ata të hjekin dorë nga një pronë e tyre. Në ndërtesë ata ishin maltretuar, kërcënuar dhe rrahur. Dëshmitari numër 3 ishte lëshuar pas intervenimit nga nëna e tij pas tri ditë burgimi dhe dëshmitari numër 4 ishte lëshuar pas katër dite burgimi dhe dokumentet lidhur me një kombibus që i përkisnin atij dhe një shitore ku ai e ushtronte biznesin si mishshitës ishin dorëzuar tek Shefqet Musliu dhe bashkëpunëtorët e tij.

III.

1. I pandehuri SHEFQET MUSLIU (me shënimet personale si më lart) ka qenë i shpallur fajtor më parë dhe i dënuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit në lëndën P nr. 199/2003 të datës 25 qershor 2004 dhe i konfirmuar me atkgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP 470/2004 të datës 27 mars 2007, me tetë (8) vite për veprën penale të rrëmbimit të dëmtuarit/dëshmitarit AK .

Për shkak se,

Me 8 shtator 2001, i akuzuari Shefqet Musliu i cili ishte i shoqëruar nga persona të tjerë urdhëroi një person i cili ishte identifikuar si AK në procedurat hetimore (i cili nuk ka dëshmuar por dëshmia e tij ishte lexuar në gjykatë) t'i shoqërojë ata në një veturë. AK ishte dërguar në një garazhë ku ai ishte kërcënuar, maltretuar dhe urdhëruar t'iu jap atyre informata lidhur me një urdhër arresti që ishte lëshuar kundër të akuzuarit, Shefqet Musliut. AK ishte lëshuar pas rreth tridhjetë (30) minutave me kushtin që ai e ofroi informatën e kërkuar.

2. I pandehuri SHEFQET MUSLIU (me shënimet personale si më lart) ka qenë i shpallur fajtor më parë dhe i dënuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit në lëndën P nr. 199/2003 të datës 25 qershor 2004 dhe i konfirmuar me atkgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP 470/2004 të datës 27 mars 2007, me dy (2) vite për veprën penale të detyrimit në tentativë të dëshmitarit 1.

Për shkak se,

Me 24 prill 2002 Shefqet Musliu iu afrua një personi të identifikuar si dëshmitari me numrin 1, e cila ishte në veturën e saj dhe i kërkoi asaj para. Pas refuzimit të saj ai e kërcënoi atë dhe i tha asaj ose paratë ose shpirtin. Dëshmitarja ishte shumë e frikësuar dhe i tha atij se ajo nuk i ka borxh atij dhe ajo nuk ka para.

Prandaj

Në pajtim me nenin 48, Paragrafi 2, nënpar. 3 i Ligjit Penal të RSFJ (1976) gjykata shqipton një **DËNIM UNIK PREJ NËNTË VITEVE** për të pandehurin **SHEFQET MUSLIU**

Në pajtim me nenin 48, Paragrafi 2, nënpar. 3 i Ligjit Penal të RSFJ (1976) gjykata shqipton **DËNIM UNIK PREJ 6 VITEVE DHE NËNTË MUAJVE** për të pandehurin **BESIM TAHIRIN**.

Koha e kaluar nga ata në paraburgim dhe koha tanimë e kaluar në burgim sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap. 470/2004 (nga 7 korriku 2003 deri me 25 maj 2011 për Shefqet Musliun dhe nga 19 qershori 2003 deri me 18 mars 2010 për Besim Tahiri) do të llogaritet në dënimin unik sipas nenit 351, paragrafi 6 i LPK-së.

ARSYETIM

Kompetenca e Gjykatës

Lënda bie nën kompetencën territoriale dhe lëndore të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit tek e cila Gjykata Supreme e Kosovës e kishte dërguar për rigjykim. Lënda më tutje bie nën kompetencën e gjyqtarëve të EULEX-it në pajtim me nenin 15 të Ligjit mbi Kompetencat (Ligji Nr 03/L-053).

Historial procedural i lëndës:

Me 20 qershor 2003, Prokurori Publik ndërkombëtar inicioi hetimin kundër të pandehurit Besim Tahiri dhe, me 9 korrik 2003 kundër të pandehurit Shefqet Musliut.

Me 9 dhjetor 2003, Prokurori Publik ndërkombëtar paraqiti aktakuzën, PP. Nr. 107/03, kundër të pandehurve Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit, e cila ishte ndryshuar me 21 janar 2004.

I pandehuri Shefqet Musliu ishte akuzuar për katër rrëmbime, dëshmitarët **FY, AK, 3** dhe **4** në kundërshtim me nenin 64 paragrafi 1, 2 dhe 4 të Kodit Penal të Serbisë (KPS) (*Gazeta Zyrtare* e RS të Serbisë, Nr. 26, 1977 me ndryshime) siç lexohet me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë [LPRSFJ] (*Gazeta Zyrtare* RSFJ Nr. 44, 8 tetor 1976 me ndryshime), detyrim në tentativë të dëshmitarit **1** në kundërshtim me nenin 180 të LPS siç lexohet me nenin 19 dhe 22 të LPRSFJ, Mbjatje e paautorizuar e armës në kundërshtim me nenin 8.2 dhe 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7 mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë nga 21 shkurti 2001 (UNMIK/REG/2001/7) dhe bashkimit kriminal në kundërshtim me nenin 227 të LPS.

I pandehuri Besim Tahiri ishte akuzuar për tri rrëmbime të dëshmitarëve **FY, 3** dhe **4** në kundërshtim me nenin 64 paragrafët 1, 2, dhe 4 të LPS siç lexohet me nenin 22 të

LPRSFJ, mbajtje të paautorizuar të armës me 17 gusht 2001 në kundërshtim me nenin 8.2 dhe 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/7 dhe bashkimit kriminal në kundërshtim me nenin 227 të LPS.

Gjykata e Qarkut të Gjilanit me 25 qershor 2004 pas mbajtjes së seancës kryesore shpalli aktgjykimin P. No. 199/2003¹ dhe shpalli fajtor të pandehurin **Shefqet Musliun** për katër pikë të rrëmbimit të dëshmitarëve **FY, AK, 3 dhe 4** dhe një pikë të detyrimit në tentativë të dëshmitarit 1. I pandehuri Shefqet Musliu ishte dënuar me burgim prej **8 viteve** në lidhje me secilën vepër të rrëmbimit të dëshmitarëve **FY, AK, 3 dhe 4**, dhe **2 vite** për veprën penale të detyrimit në tentativë të dëshmitarit 1. Gjykata e Qarkut të Gjilanit dënoi të pandehurin Shefqet Musliun me një dënim unik prej **12 viteve burgim**. Me të njëjtin aktgjykim Shefqet Musliu ishte liruar nga dy pikë të mbajtjes së paautorizuar të armës dhe një pikë të bashkimit kriminal.

I pandehuri **Besim Tahiri** ishte shpallur fajtor për tri pikë të rrëmbimit të dëshmitarëve **FY, 3 dhe 4** dhe ishte dënuar me një kohëzgjatje prej 5 viteve në lidhje me secilën vepër penale të rrëmbimit të dëshmitarëve **FY, 3 dhe 4**. Gjykata e Qarkut në Gjilan dënoi të pandehurin Besim Tahiri me një dënim unik prej **7 viteve burgim**. I pandehuri Besim Tahiri ishte liruar nga një pikë e mbajtjes së paautorizuar të armëve si dhe bashkimit kriminal.

Me 27 mars 2007, pas vendosjes rreth ankesave të paraqitura nga avokatët mbrojtës të të pandehurve, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin AP. 470/2004, pjesërisht anuloi aktgjykimin P. No. 199/2003, dhe e ktheu lëndën në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit për rigjykim në lidhje me rrëmbimin e dëshmitarit **FY**, në kundërshtim me nenin 64, paragrafët 1 dhe 2 të LPS të lexuar me nenin 22 të LPRSFJ dhe në lidhje me dënimin unik prej 12 viteve burgim kundër të pandehurit **Shefqet Musliut** dhe me një dënim unik prej 7 viteve kundër të pandehurit **Besim Tahirit**.

Me të njëjtin aktgjykim Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi aktgjykimin P. Nr. 199/2003, lidhur me dënimet dhe burgimet prej **tetë viteve** në lidhje me secilën vepër të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4 si dhe **AK**, dhe **dy vite** për detyrim në tentativë të dëshmitarit 1, kundër të pandehurit Shefqet Musliu. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ishte vërtetuar gjithashtu në lidhje me dënimet dhe burgimet prej **pesë viteve** në lidhje me secilën vepër të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4 kundër të pandehurit Besim Tahirit².

Me aktvendimin AP nr. 470/2004 i datës 10 mars 2010 Gjykata Supreme e Kosovës përmirësoi Aktgjykimin e saj AP. 470/2004, të datës 27 mars 2007, në një gabim material

¹ Me të njëjtin aktgjykim gjykata gjithashtu shpalli fajtor të pandehurin Feriz Qerimi (tani i ndjerë) për veprën penale të rrëmbimit të dëshmitarit **FY** dhe e dënoi atë me 5 vite burgim.

² E përmirësuar me Aktvendimin e Gjykatës Supreme AP. 470/2004, të datës 10 mars 2010

të dukshëm lidhur me sanksionet për të pandehurit Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit në pjesën e konfirmuar të aktgjykimit.

Procedurat e ri-gjykimit të parë para Gjykatës së Qarkut të Gjilanit

Pas udhëzimeve nga Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata e Qarkut të Gjilanit mbajti seanca të ri-gjykimit, me 1 shtator dhe 5 tetor 2010.

Me aktvendimin P.Nr. 181/2007, të datës 1 shtator 2010, Gjykata e Qarkut të Gjilanit pushoi procedurat penale kundër Feriz Qerimit për shkak të vdekjes së tij.

Me 4 tetor 2010, Zyra e Prokurorisë Publike në Gjilan dorëzoi në Gjykatë një njoftim për tërheqjen nga ndjekja kundër dy të pandehurve për veprën penale me të cilën ata ishin akuzuar (Rrëmbimi i dëshmitarit FY), në pajtim me nenin 51 të LPP-së. Tërheqja ishte konfirmuar gojarisht nga Prokurori Publik në seancën e 5 tetorit 2010. Kështu që Gjykata e Qarkut të Gjilanit me Aktgjykimin P.nr. 181/07, të datës 5 tetor 2010, refuzoi akuzën penale të rrëmbimit të dëshmitarit FY sipas nenit 64 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Penal të Serbisë në lidhje me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë (pika C e aktakuzës së ndryshuar) kundër të pandehurve Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit.

Siç ishte udhëzuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata e Qarkut të Gjilanit vendosi gjithashtu edhe rreth dënimit unik dhe shqiptoi dënimin unik prej 10 viteve e 6 muajve burgim për të pandehurin Shefqet Musliu për veprat penale tanimë të konfirmuara të rrëmbimit të dëshmitarëve 3, 4 dhe AK dhe veprat penale të detyrimit në tentativë të dëshmitarit 1. Gjykata e Qarkut të Gjilanit gjithashtu shqiptoi një dënim unik prej 6 viteve e 9 muajve burgim për të pandehurin Besim Tahiri për veprat penale tanimë të konfirmuara për rrëmbimin e dëshmitarëve 3 dhe 4.

Aktgjykimi P.nr. 181/07 ishte ankimuar me 15 tetor 2010 dhe 2 nëntor 2010 nga avokatët mbrojtës të të dy të pandehurve. Pas vendosjes së ankesave me 25 maj 2011, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin AP. No. 351/2010, anuloi Aktgjykimin P.nr. 181/07 dhe e ktheu lëndën në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit për rigjykim për shkak se Aktgjykimi nuk përmbante përshkrim të detajuar për akuzën e refuzuara (në lidhje me rrëmbimin e dëshmitarit FY) dhe dënimin unik. Më tutje theksohet se Gjykata e shkallës së parë nuk ka sqaruar se si dënimet individuale janë kombinuar para vendosjes së shqiptimit të dënimit unik. Kjo mungesë përbën një shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale siç përcaktohet me nenin 364 paragrafin 1 pika 11 e Ligjit mbi Procedurën Penale.

Procedurat e rigjykimit të dytë para Gjykatës së Qarkut të Gjilanit

Ligji i aplikueshëm procedural dhe substancial

Aktakuza e ndryshuar në këtë lëndë është paraqitur në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit me 21 janar 2004, para hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, tani Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) me 6 prill 2004. Procedurat penale janë ende në pritje në gjykatën e shkallës së parë lidhur me veprën penale të

rrëmbimit të dëshmitarit FY dhe dënimit unik pas Aktvendimit të Gjykatës Supreme. Për këtë arsye dhe në pajtim me nenin 550 KPPK ligji i aplikueshëm procedural është Ligji mbi Procedurën Penale (LPP), Gazeta Zyrtare Not. 26/86. Kjo është gjithashtu e konfirmuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme AP. 470/2007, të datës 27 mars 2007, faqe nr.24, "Vlerësimi i Gjykatës Supreme" si dhe me Aktvendimin e Gjykatës Supreme AP. 351/2010, të datës 25 maj 2011, faqe nr. 6 pika C "ligji i aplikueshëm".

Konstatimet e Gjykatës

Lidhur me tërheqjen nga ndjekja

Me 4 tetor 2010 Prokuroria Publike dorëzoi në Gjykatë një njoftim për tërheqjen nga ndjekja kundër dy të pandehurve lidhur me veprën penale të cilët ata janë të akuzuar (Rrëmbimi i dëshmitarit FY), sipas nenit 51 të LPP-së. Tërheqja ishte konfirmuar gojarisht nga Prokurori Publik në seancën e 25 tetorit 2011 dhe në seancën e 2 dhjetorit 2011. Në këtë rast Gjykata është e detyruar me dispozitën e nenit 349, paragrafi 3 i LPP-së dhe akuza penale në pritje e rrëmbimit të dëshmitarit FY sipas nenit 64 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Penal të Serbisë në lidhje me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë (pika C e aktakuzës së ndryshuar) kundër të pandehurve Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit u dashtë që të refuzohej.

Në fjalën e vet përfundimtare Prokurori i Qarkut të Gjilanit, Z.Fahri Nuhiu përsëriti tërheqjen nga ndjekja lidhur me veprën penale të rrëmbimit të dëshmitarit FY dhe e luti gjykatën që të ndjekë në mënyrë të kujdesshme udhëzimet e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me dënimet unike për të pandehurit. Prokurorja e EULEX-it, Znjsh.. Elisa Moretti u pajtua me fjalën përfundimtare të kolegut të saj.

Në fjalën e vet përfundimtare avokatët mbrojtës Masar Morina dhe Nike Shala kundërshtuan pjesët tanimë të konfirmuara të veprave (lidhur me dëshmitarët 3, 4 dhe AK) si dhe kërkuan nga Gjykata të mos aplikojë ish-ligjin e Jugosllavisë dhe Ligjin Penal të Serbisë.

Në fjalën e vet përfundimtare i pandehuri Shefqet Musliu u pajtua me fjalimin përfundimtar të avokatit të tij mbrojtës dhe kërkoi nga gjykata t'ia kthej dokumentin "Marrëveshja e Konçulit" për shkak se ai paraqet një gjë të vlefshme për të pasi që ai ishte një nga palët që e nënshkruan atë .

I pandehuri Besim Tahiri nuk tha asgjë në fjalën e vet përfundimtare.

Në lidhje me ligjin e aplikueshëm kjo çështje është qartazi e sqaruar më parë dhe tanimë e konfirmuar nga Gjykata e Supreme e Kosovës kështu që Gjykata nuk e diskutoi më tutje këtë çështje.

Lidhur me dënimet unike

Pasi që akuzat lidhur me rrëmbimin e dëshmitarit e FY janë hedhur poshtë dhe pas udhëzimeve të marra nga Gjykata Supreme e Kosovës trupi gjykses duhet të vendosë lidhur me dënimin unik për t'u shqiptuar për të pandehurit me sa vijon:

Në lidhje me Shefqet Musliun – për pjesën tanimë të konfirmuar të dënimit për veprat penale të rrëmbimit të dëshmitarëve 3, 4 dhe AK, për secilen prej të cilave ai ishte dënuar me 8 vite burgim dhe për veprën penale të detyrimit në tentativë të dëshmitarit 1 për të cilën ai ishte dënuar me dy vite burgim dhe

Në lidhje me Besim Tahirin – për pjesën tanimë të konfirmuar të dënimit për veprat penale të rrëmbimit të dëshmitarëve 3, 4, për secilen prej të cilave ai ishte dënuar me 5 vite burgim.

Pasi që, nga kryerja e veprave penale tanimë të konfirmuara nga të pandehurit Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit në vitin 2000-2002, ekziston Kodi i Ri Penal në fuqi që nga viti 2004, Kodi Penal i Kosovës (KPK), për këtë arsye dhe në pajtim me nenin 2, nënpar. 2 të KPK-së (neni 4 i Ligjit penal të RSFJ 1976) i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprave penale) trupi gjykues duhet të vendosë cili prej tyre është më i favorshëm për të pandehurit.

Dënimi unik është i rregulluar me nenin 48 të Ligjit Penal të RSFJ dhe me nenin 71 të KPK-së.

Neni 48, paragrafi 2, nënparagrafi 3, parasheh “*dënimi unik do të përbëhet nga dënimi më i rëndë i vlerësuar, por dënimi unik nuk mund të jetë më i lartë se totali i të gjitha dënimeve të shqiptuara, dhe nuk mund ta kaloj periudhën 15 vjeçare të dënimit me burg.*

Neni 71, paragrafi 2, nënparagrafi 2 i KPK-së ofron “*Nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet vjetësh;*”. Kështu që, është e qartë se neni 48 i Ligjit penal të RSFJ-së është ligji penal më i favorshëm për t’u aplikuar gjatë përcaktimit të dënimit unik për të dy të pandehurit.

Pasi që Gjykata Supreme ka anuluar gjithashtu edhe dënimin unik të shqiptuar me aktgjykimin P. no. 181/2007, të datës 6 tetor 2010, gjatë ankesës së parashtruar vetëm në emër të akuzuarve, Gjykata është e detyruar me dispozitat e nenit 390, paragrafi 4 i lexuar së bashku me nenin 378 të LPP-së, kështu që maksimumi i dënimit unik nuk do tejkalojë 10 vite e gjashtë muaj për Shefqet Musliun dhe 6 vite e 9 muaj për Besim Tahirin.

Para vendosjes për dënime unike, me 8 nëntor 2011 Gjykata *ex-officio* kërkoi informata nga Gjykata Komunale e Gjilanit lidhur me historiatin penal të dy të pandehurve Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit dhe raporte të detajuara nga Burgu i Dubravës lidhur me sjelljen e dy të pandehurve.

Gjatë vendosjes për dënime unike gjykata mori parasysh disa çështje si; seriozitetin e veprave penale, kohën e kaluar që nga kryerja e veprave penale, faktin që aktakuza e ndryshuar përmban një vepër më pak sesa ajo e mëparshmeja dhe sjellja e kaluar dhe e tanishme për të dy të pandehurit.

Gjykata administroi si prova dhe iu kushtoi vëmendje të veçantë “Çertifikatave mbi Historiatin penal” të pranuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit, me datë 9 nëntor 2011, në emër të pandehurve Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit si dhe raporteve të vlerësimit shoqëror të datës 11 nëntor 2011 nga Burgu i Dubravës.

Lidhur me të pandehurin Shefqet Musliu, në bazë të Çertifikatës nga Gjykata Komunale e Gjilanit, nuk ka asnjë lëndë penale kundër të pandehurit Shefqet Musliut. Raporti i vlerësimit shoqëror ishte mjaft pozitiv në lidhje me të pandehurin Shefqet Musliun se ai ishte përshtatur me rregullat e shërbimit korrektues, është person që sillet mirë dhe korrekt dhe pas procesit të ri-socializimit i cili ka shkuar normalisht dhe ne mënyrë pozitive Ai nuk paraqet rrezik për ambientin. Për më shumë i pandehuri ishte i motivuar për sjelljen e tij të mirë dhe të ardhmen e tij në shoqëri.

Duke marrur parasysh këta faktorë në lidhje me nenin 48, paragrafi 2, nënparagrafi 3 dhe neni 41 i Kodit penal të RSFJ-së, gjykata shqiptoi një dënim unik prej 9 viteve burgim për Shefqet Musliun dhe është e bindur se qëllimi i dënimit është arritur sipas nenit 33 të Kodit penal të RSFJ-së.

Në lidhje me të pandehurin Besim Tahiri, në bazë të Çertifikatës së lëshuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit, i pandehuri Besim Tahiri është dënuar për një vepër tjetër penale (neni 297 paragrafi 3 nënparagrafi 1 i KPK-së) dhe ai është dënuar me një gjobë me shumë 150€.

Raporti i vlerësimit shoqëror i pranuar nga Burgu i Dubravës ka qenë mjaft negativ për të pandehurin Besim Tahiri p.sh, se i pandehuri Besim Tahiri, nuk ka pasur ndryshim pozitiv të kënaqshëm në sjellje dhe ri-socializimi ka shkuar ngadalë dhe ai pendohej pak. Përfundimisht shërbimi korrektues ka pasur efekt të vogël pozitiv në personalitetin e tij.

Më tutje, raporti shënon se i pandehuri Besim Tahiri është përpjekur të arratiset nga burgu si dhe ai iu është nënshtruar masave disiplinore për thyerjen e rregullave të Burgut. Kështu që Gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese lidhur me të pandehurin Besim Tahirin. Në lidhje me këta faktorë sipas nenit 48, paragrafi 2, nënparagrafi 3 dhe neni 41 i Kodit Penal të RSFJ, Gjykata ka shqiptuar një dënim unik prej 6 viteve e 9 muajve burgim për Besim Tahirin dhe është e bindur se qëllimi i dënimit është arritur sipas nenit 33 të Kodit Penal të RSFJ.

Koha e kaluar nga të pandehurit në paraburgim dhe koha tanimë e kaluar në burg sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. 470/2004, nga 7 korriku 2003 deri me 25 maj 2011 për Shefqet Musliun dhe nga 19 qershori 2003 deri 18 mars 2010 për Besim Tahirin do të llogaritet në dënimin unik në pajtim me nenin 50 të Kodit penal të RSFJ-së dhe nenit 351, paragrafi 6 i LPP-së.

Një aktvendim i veçantë lidhur me shpenzimet e procedurës penale do të lëshohet.

Lidhur me kërkesën për të kthimin e sendeve të konfiskuara nga të pandehurit Gjykata do të lëshojë një aktvendim të veçantë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

Lënda P. nr 118/11, 2 dhjetor 2011

Mariola Pasnik

Dariusz Sielicki

Rasim Rasimi

Kryetari i trupit gjykues

Anëtar i trupit gjykues

Anëtar i trupit gjykues

Stephen Parkinson

Procesmbajtës



Anila Shehu

Përkthyes

Mjeti juridik:

Ky aktgjykim mund të ankimohet te Gjykata Supreme e Kosovës. Ankesa e adresuar në Gjykatën Supreme të Kosovës duhet të dërgohet në Gjykatën e Qarkut të Gjiçanit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dorëzimi i këtij aktgjykimi tek palët (neni 359, paragrafi 1 LPK).

Pala e dëmtuar, e cila nuk ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt në këtë seancë kryesore, brenda tetë ditëve nga data e pranimit të aktgjykimit mundet të dorëzojë një kërkesë për kthim në *status quo ante* nëse në atë kërkesë ai deklaron qëllimin e tij të rifilloj ndjekjen (neni 61, paragrafi 2 LPK).